



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Udhëzues i Aplikimit
‘Për zbatimin e skemës së granteve’

Skemë granti për biznese inovative

Shkodër, Prill 2026

PËRMBAJTJA:

- 1. Hyrje**
- 2. Qëllimi dhe Objektivat**
- 3. Përfitimet e një biznesi inovativ**
- 4. Përfituesit e skemës**
- 5. Buxheti**

UDHËZUESI I APLIKIMIT

- 1. Çfarë është granti për bizneset inovative?**
- 2. Mbështetja financiare**
- 3. Aplikantët e pranueshëm**
- 4. Shpenzimet që mund të mbuloohen nga skema**
- 5. Mbulimi gjeografik**
- 6. Strukturat e skemës së grantit dhe detyrat e tyre**
- 7. Mënyra e procedimit të skemës së grantit**

1. Hyrje

Zbatimi i politikave vendore për mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve të bizneseve përbën një sfidë, prandaj është e rëndësishme të përqendrohemi në inkurajimin e iniciativave që nxisin dhe zhvillojnë bizneset e reja dhe ekzistuese. Një gjë e tillë është thelbësore për ndërtimin e një ekonomie të fortë, konkurruese dhe inovative.

Kur këto iniciativa ndërthurin konceptet e ekonomisë dhe inovacionit, ato krijojnë një model të ri zhvillimi ekonomik që është në gjendje të përballojë sfidat bashkëkohore të zhvillimit. Një qasje e tillë quhet inovacion në biznes dhe është një term që po përdoret gjërësisht. Inovacioni në biznes i referohet procesit të prezantimit të ideve, metodave, produkteve ose shërbimeve të reja që krijojnë vlerë për biznesin dhe klientët e saj. Ai përfshin të menduarit në mënyrë krijuese për të zgjidhur problemet, për të përmirësuar proceset dhe ruajtjen e konkurrueshmërisë në treg. Pavarësisht nëse është një produkt i ri, një strategji marketingu e ndryshuar, ose një proces më efikas, inovacioni është i rëndësishëm për të mbajtur një biznes konkurrues dhe të suksesshëm. Zbatimi i një procesi të tillë krijon përparësi të qëndrueshme për biznesin, pasi është në gjendje t'i japë zgjidhje afatgjatë ndryshimit të tendencave të reja të tregut.

Qëllimi ynë është të promovojmë një model të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, për t'i dhënë proceseve, produkteve dhe shërbimeve të bizneseve një vlerë të shtuar në treg. Ky proces inovativ përfshin të gjitha fazat e ciklit jetësor të një produkti, nga zhvillimi i tij fillestar, prodhimi, shpërndarja, përdorimi dhe deri te riciklimi ose asgjësimi i tij. Kjo qasje e re menaxhimi çon në zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit dhe tërheqjen e investimeve të reja për biznesin, dhe njëkohësisht ndikon në uljen e kostove dhe zhvillimin e bizneseve të bazuara në ide inovative, krahasuar me alternativat ekzistuese.

Në kushtet e tregut modern, ku ndryshimet teknologjike dhe konkurrenca janë të vazhdueshme, inovacioni është bërë një domosdoshmëri dhe jo më një zgjedhje. Bizneset që synojnë të rriten, të mbeten të njohura dhe të vlerësuara në treg duhet të jenë të gatshme të përshtaten dhe të krijojnë vazhdimisht zgjidhje të reja. Përmes inovacionit, kompanitë arrijnë jo vetëm të përmirësojnë produktet dhe shërbimet e tyre, por edhe të përgjigjen më mirë ndaj nevojave të klientëve, të krijojnë avantazh konkurrues dhe të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm në një mjedis gjithnjë e më dinamik.

Në këtë kontekst, Bashkia Shkodër synon të forcojë bashkëpunimin me sektorin privat, në koordinim të ngushtë me institucionet e tjera përgjegjëse për të ofruar një qasje të qëndrueshme dhe efektive, e orientuar drejt zhvillimit ekonomik dhe e bazuar në një skemë granti për financimin e sipërmarrësve aspirantë që kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues dhe janë të regjistruar në Bashkinë Shkodër. Kjo, jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe si një praktikë e mirë, të cilën parashikon ta zbatojë në vitet në vazhdim për disa sektorë të ekonomisë.

Skema e Grantit do të zbatohet përmes një procesi të bazuar në konkurrencë, me qëllim që të sigurohet kthimi më i lartë i mundshëm i investimit. Ky proces konkurrues do të bëjë të mundur përzgjedhjen e projekteve më të mira dhe më të qëndrueshme, duke garantuar përdorimin efikas të fondeve dhe maksimizimin e përfitimeve për bizneset dhe komunitetin.

2. Qëllimi dhe Objektiva

2.1 Çfarë është Ekonomia “inovative”?¹

Ekonomia “inovative” është një element i ekonomisë i bazuar në prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e ideve, informacionit dhe njohurive. Një sistem i bazuar në treg që përdor kërkimin dhe zhvillimin për të krijuar produkte ose shërbime të reja. Inovacioni në ekonomi mund të marrë shumë forma, si teknologjitë e reja, modelet dhe proceset e biznesit ose strukturat organizative. Ekonomia e inovacionit është një sistem i ndërlidhur ku bizneset vazhdimisht mësojnë dhe zhvillojnë mënyra të reja për të përdorur teknologjinë për përfitime komerciale. Sipërmarrja është një komponent kyç i ekonomisë së inovacionit pasi inkurajon individët të ndërmarrin rreziqe duke investuar burimet e tyre në zhvillimin e ideve inovative.

2.2 Çfarë është biznesi “inovativ”?²

Një biznes “inovativ” përfshin riformësimin e proceseve, transformimin e përvojave të klientëve dhe krijimin e tregjeve krejtësisht të reja. Inovacioni u mundëson kompanive të përshtaten me ndryshimet e shpejta të teknologjisë, kërkesave të konsumatorëve dhe dinamikave të tregut. Në një mjedis gjithnjë e më konkurrues, bizneset që nuk arrijnë të përshtaten dhe të zhvillojnë ide të reja rrezikojnë të humbasin rëndësinë e tyre në treg, të mbeten pas konkurrentëve dhe, në afat të gjatë, të dalin nga tregu. Nga ana tjetër, kompanitë që përqafojnë zgjidhjen krijuese të problemeve, inkurajojnë mendimin ndryshe dhe investojnë në ide të reja, pozicionohen më mirë për të kapur mundësitë në zhvillim. Këto biznese jo vetëm që reagojnë ndaj ndryshimeve, por shpesh bëhen vetë nxitës të tyre. Përmes inovacionit, ato rrisin efikasitetin, përmirësojnë cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, si dhe ndërtojnë marrëdhënie më të forta dhe më të qëndrueshme me klientët.

3. Qëllimi dhe Objektivat

3.1 Qëllimi i Skemës së Grantit

Qëllimi është të krijojë mundësi të reja ekonomike për sipërmarrësit aspirantë dhe bizneset ekzistuese, bazuar në një skemë granti, e cila mbështet zhvillimin e iniciativave ekonomike lokale, duke nxitur një qasje inovative në zhvillimin e biznesit. Kjo skemë granti ka për qëllim të stimulojë rritjen dhe zhvillimin e bizneseve lokale dhe në të njëjtën kohë promovimin e ideve, produkteve dhe shërbimeve inovative.

3.2 Objektivat e Skemës së Granteve

- Të krijojë një model transparent dhe të bazuar në projekte konkrete për mbështetjen e bizneseve.

¹ European Commission. (2013). *Entrepreneurship 2020 Action Plan: Reigniting the entrepreneurial spirit in Europe*. Publications Office of the European Union. E disponueshme ne: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfefindmkaj/https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52013IP0512>

² OECD. (2010). *The OECD innovation strategy: Getting a head start on tomorrow*. OECD Publishing. E disponueshme ne: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfefindmkaj/https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2010/05/the-oecd-innovation-strategy_g1ghcb7c/9789264083479-en.pdf.

- Të ndërgjegjësujt dhe nxisë individët dhe bizneset lokale shkodrane që të angazhohen në veprimtari ekonomike lokale.
- Të mbështesë krijimin dhe zgjerimin e bizneseve përmes zhvillimit dhe zbatimit të ideve të reja, teknologjive bashkëkohore dhe praktikave inovative që rrisin konkurrueshmërinë dhe vlerën në treg.
- Të përmirësojë aftësitë e nevojshme rreth planifikimit të biznesit dhe menaxhimit financiar, që të jenë të suksesshëm në krijimin dhe zgjerimin e bizneseve të tyre.

3.3 Përfitimet e Skemës së Granteve

Kjo Skemë financimi, që po zbatohet për herë të dytë në Bashkinë Shkodër, do të nxisë krijimin e bizneseve inovative, të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e shoqërive prodhuese, dinamike dhe të qëndrueshme. Këto biznese mund të luajnë një rol kryesor në përparimin teknologjik dhe ekonomik, duke kontribuar në rritjen e konkurrencës, zhvillimin e ideve të reja dhe krijimin e vendeve të punës.

Nga ana tjetër skema do të përmirësojë më tej bashkëpunimin ndërmjet bashkisë dhe bizneseve lokale.

Përfitimet e bizneseve inovative përfshijnë hyrjen në tregje të reja dhe të pashfrytëzuara, rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit përmes përdorimit të teknologjive dhe proceseve të reja, kursimin e kostove dhe përmirësimin e performancës së stafit, përmes krijimit të një ambienti pune më efikas dhe të motivuar.

Disa nga përfitimet e një biznesi inovativ:³

Diferencim konkurrues – Inovacioni mundëson të ofrohen produkte dhe shërbime unike që i vendosin bizneset në një pozitë të dalluar në treg. Studimet tregojnë se inovacioni i produktit mund të rrisë avantazhin konkurrues deri në 53.1%, ndërsa inovacioni i proceseve kontribuon me 47.2%, dhe inovacioni i fokusuar te njerëzit shton 44.5%.

Zgjidhje të bazuara tek klienti – Duke zhvilluar vazhdimisht ofertat sipas nevojave të klientëve, mund të tërhiqen dhe të mbahen klientë të besuar. Rreth 65% e klientëve presin që kompanitë të përshtatin vazhdimisht produktet dhe shërbimet për të plotësuar nevojat dhe preferencat e tyre.

Rritje dhe zgjerim – Inovacioni hap mundësi të reja për zgjerimin e biznesit, hyrjen në tregje të reja dhe rritjen e të ardhurave.

Efikasitet operativ – Përdorimi i mjeteve smart dhe optimizimi i proceseve përmes inovacionit ndihmon ekipet të punojnë më shpejt dhe më efektivisht. Shumë biznese që përdorin mjete digjitale inovative raportojnë rritje produktiviteti deri në 20–30%, dhe efikasiteti mund të rritet edhe më shumë duke përdorur mbështetje virtuale për detyra rutinë.

Angazhimi i talentit – Ofrimi i mundësive për punonjësit të eksplorojnë ide të reja rrit motivimin, kënaqësinë dhe mbajtjen afatgjatë të stafit.

³ IMD Business School. (n.d.). *Innovation in business: Importance, benefits, and examples*. E disponueshme në <https://www.imd.org/reflections/innovation-in-business-importance-benefits-examples/>.

Rezistencë e biznesit – Inovacioni i vazhdueshëm forcon aftësinë për t’u përshtatur gjatë krizave dhe për të “lulëzuar” në kushte të ndryshuara.

3.5 Përfituesit e skemës së grantit:

Sipërmarrësit Aspirantë: Individë që kanë ide për të filluar një biznes të ri dhe kërkojnë mbështetje për të realizuar këto ide.

Bizneset ekzistuese: Biznese ekzistuese me qarkullim vjetor $\leq 8,000,000$ lekë/vit⁴ që kërkojnë të zgjerohen, të modernizohen ose të implementojnë praktika të qëndrueshme dhe inovative.

⁴ Ligji nr .9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar.

UDHËZUESI APLIKIMIT

“Krijimi i një skeme garancie për bizneset inovative, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante”

Ky udhëzues përfshin të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e detajuar të nevojshëm për të zbatuar në mënyrë profesionale dhe transparente skemën e grantit. Udhëzuesi bazohet në nenin 28 pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 – 2028, të Bashkisë Shkodër”; fish projekti P.AC141.Q1.O2.A3, “Skemë granti për biznese inovative“ të buxhetit të vitit 2026 të Bashkisë Shkodër dhe programit buxhetor 2026 -2028”; Kërkesës nr. 1024 prot, datë 15.01.2026 drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me objekt: ‘Njoftim për ndihmën shtetërore për projektin “Skemë granti për biznese inovative“, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante; “Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.453/2 prot, datë 12.02.2026 me objekt: “Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Sa më sipër merr iniciativën e hartimit të këtij udhëzuesi për zbatimin e dhënies së Granteve për ide dhe biznese inovative.

1. Çfarë është Granti për “Bizneset Inovative”?

Granti për bizneset inovative është një aktivitet i Bashkisë Shkodër, i financuar nga burime publike (të parashikuara në buxhetin e vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 – 2028, të Bashkisë Shkodër, në Programin AC141 “Mbështetje për zhvillimin Ekonomik”, i projektuar për të mbështetur financiarisht (Grant) bizneset e reja, të cilat bazohen në një model inovativ, ose biznese ekzistuese që synojnë të transformohen përmes zbatimit të ideve dhe praktikave inovative.

Kjo skemë granti është hartuar për t’i shërbyer individëve/sipërmarrësve aspirantë, por edhe bizneseve ekzistuese.

Projekti synon të mbështesë financiarisht kategoritë si më poshtë:

- Individë/sipërmarrës aspirantë që synojnë të prodhojnë produkte inovative, të ofrojnë shërbime të reja ose të zbatojnë procese bashkëkohore dhe kreative në biznesin e tyre;
- Biznese ekzistuese me një qasje inovative dhe të orientuar drejt zhvillimit;
- Biznese që shndërrojnë burime ose materiale të pashfrytëzuara në produkte, shërbime apo zgjidhje me vlerë të shtuar përmes inovacionit;
- Biznese që shfrytëzojnë potencialin lokal duke aplikuar modele të reja dhe ide inovative në komunitet;
- Biznese të tilla si agrobiznes (prodhim, përpunim, tregtim) që zbatojnë teknologji moderne, metoda inovative dhe modele të reja të zhvillimit dhe i tregtojnë produktet e tyre në nivel lokal;
- Biznese që përdorin teknologji të avancuara, materiale alternative ose zgjidhje moderne në proceset e prodhimit dhe zhvillimit të produkteve;
- Biznese me ide inovative në krahasim me bizneset e tjera, të cilat ofrojnë zgjidhje të reja dhe kreative për adresimin e sfidave ekonomike, sociale apo të tregut;

2. Mbështetja financiare

Fondi total i Skemës së Granteve është **5,000,000 lekë**, dhe financohet plotësisht nga Bashkia Shkodër.⁵

Granti për aplikim: Aplikimet që plotësojnë kriteret e kësaj skeme janë ato që kërkojnë një buxhet deri në 500,000 lekë⁶.

Granti do të ofrojë mbështetje për shtetasit shqiptarë mbi 18 vjeç, që kanë një ide biznesi ose drejtojnë një biznes ekzistues, janë banues në Bashkinë Shkodër dhe kanë dëshirë të zhvillojnë biznese inovative. Kohëzgjatja e projekteve do të jetë nga lidhja e kontratës deri me 31 dhjetor 2026, dhe shuma do të shpërndahet sipas planit financiar të aplikimeve fituese.

- Skema e grantit mbulon 80% të shpenzimeve të pranueshme brenda limitit të sipërpërmendur, ndërsa pjesa tjetër duhet të mbulohet nga vetë aplikuesi në masën 20% të vlerës së projektit. Bashkëfinancimi mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare⁷.
- Grantet e alokuara në këtë thirrje mund të mbulojnë shpenzimet e personelit deri në masën 20% të shumës së kërkuar. Ndërsa, pjesa tjetër prej 80% të fondeve, duhet të parashihen për aktivitetet e projektit.
- Granti nuk mund të jepet më shumë se një herë për të njëjtën sipërmarrje, brenda 2 viteve. Pra nëse një biznes zgjidhet fitues dhe financohet, ai/ajo nuk mund të aplikojnë në thirrjen që do të shpallet në vitin pasardhës nga Bashkia Shkodër.
- Efektet financiare për zbatimin e këtij aktiviteti do të përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Shkodër.
- Bashkia ka të drejtën për të mos ndarë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet që nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.
- Aplikantët e përzgjedhur mund të planifikojnë financim tjetër shtesë duke përdorur instrumente financiare (kredi, hua, grante, etj.) të disponueshme në Shqipëri nëpërmjet institucioneve financiare ose projekteve të financuara nga donatorë të tjerë, ose me financat e tyre. Në të gjitha rastet e mësipërme, financimi shtesë duhet të deklarohet bashkë me burimin e financimit. Financimi shtesë duhet të përdoret së bashku me asistencën e grantit për fillimin e planit të biznesit, prandaj burimi i financimit duhet

⁵ Plani i Ndhmës Shtetërore do të zbatohet për vitet 2026 – 2028 sipas “Shkresës së Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 453/2 prot, datë 12.02.2026.

⁶ Vlera totale e vënë në dispozicion vetëm për këtë vit është 5,000,000 lekë prandaj për vitet e ardhëshme është objekt rishikimi në përputhje me parashikimet buxhetore vjetore, përfshirë edhe vlerën e grantit. Gjithashtu objekt rishikimi janë edhe ndarja e shpenzimeve personel/aktivitete.

⁷ Bashkëfinancimi mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare, por mund të shprehet me kontribut në natyrë (in-kind), që mund të jenë paga, vlerë qeraje ambjenti (për bizneset ekzistuese), vlerë pajisjesh ekzistuese, etj. **Shembull:** Nëse aplikoni për shumën prej 500,000 lekësh, 20% e kësaj shume do të bashkëfinancohet nga aplikanti, duke e rritur vlerën totale të projektit në 625,000 lekë (500,000 lekë + 20% kontributi nga aplikanti). Nëse aplikoni për shumën prej 400,000 lekësh, 20% e kësaj shume do të bashkëfinancohet nga aplikanti, duke e rritur vlerën totale të projektit në 480,000 lekë (400,000 lekë + 20% kontributi nga aplikanti).

të përfshihet në planin e biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit.

- Nëse instrumenti financiar do të përdoret për zgjerim të mëtejshëm të biznesit, kjo mbështetje shtesë e përfituar pritet që vetëm të raportohet në vizitat dhe raportet e monitorimit.
- Shpenzimet e parakryera nuk do të njihen si investim por vetëm shpenzimet pas nënshkrimit të kontratës së grantit janë të vlefshme.
- Përfituesit e fondeve nuk janë të autorizuar për kalimin e tyre tek palë të treta. Të gjithë detajet specifike mbi kohën dhe pagesat do të përcaktohen në marrëveshjen kontraktuale të grantit në përputhje me projektin dhe specifikat e tij.

3. Likuidimi i shpenzimeve:

Pagesa e grantit të miratuar bëhet me transfertë bankare. Bashkia e Shkodrës do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës, sipas realizimit të buxhetit të përcaktuar në aplikim, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate nga fondi i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër.

Levrimi i shumës do të bëhet sipas buxhetit të përcaktuar në aplikim. Kusht për lëvrimin e një shume është realizimi i shpenzimeve dhe dorëzimi i dokumentacionit mbështetës narrativ dhe financiar, dhe verifikimit të tij nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik për shpenzime që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet e biznesit, sipas pikës 6.1 për periudhën kohore nga nënshkrimi i kësaj kontrate deri në përfundim të saj.

4. Aplikantët e pranueshëm

Aplikantët e pranueshëm të Skemës janë të gjithë individët, shtetas shqiptarë me moshë mbi 18 vjeç, banorë të Bashkisë Shkodër, të cilët kanë një ide për të krijuar një biznes inovativ, i cili do të zbatohet në territorin e Bashkisë Shkodër.

Çdo aplikant mund të marrë pjesë me vetëm një ide biznesi për çdo thirrje. Nëse shpallet fitues, ai nuk mund të aplikojë vitin pasardhës.

Aplikimet nga bizneset e reja do të pranohen nëse plotësohen kriteret e sipërpërmendura dhe nëse aplikuesi:

1. Është i regjistruar dhe është banor në Shkodër;
2. Është mbi moshën 18 vjeç;
3. Nuk është në likuidim, falimentim apo procedurë për mbyllje;
4. Ka paguar të gjitha detyrimet ndaj tatimeve si dhe taksat dhe tarifatat vendore;
5. Është i gatshëm të regjistrojë biznesin e tij/saj në Shkodër para nënshkrimit të kontratës me Bashkinë Shkodër (në rastin e individëve).

5. Aplikantë jo të pranueshëm

Aplikantët që nuk përmbushin kriteret për t'u përzgjedhur janë ata, të cilët kanë një konflikt interesi me palët e përfshira në skemë.

Gjithashtu, nuk pranohen ata aplikues që kanë përfituar grante nga Bashkia Shkodër dhe nuk kanë mbyllur me sukses kontratën përkatëse.

Aplikantët ideja e biznesit e të cilëve nuk përmban një qasje ose proces inovativ për

zhvillimin e biznesit.

6. Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema

6.1 Shpenzimet e pranueshme nga skema

Shpenzimet e njohura që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- Blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, website si edhe software dhe asete të tjera jo të prekshme të cilat do të shërbejnë për të diversifikuar prodhimin me produkte të reja ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të këtyre produkteve;
- Shpenzime për asete të tjera të paprekshme (liçenca, markim dhe patentim produktesh);
- Pagat dhe sigurimet do të mbulohen vetëm për të punësuarit që lidhen drejtpërdrejtë me procesin e prodhimit të produkteve/shërbimeve, deri në 2 muajt e parë nga fillimi i aktivitetit të biznesit, por pa tejkalar më shumë se 20% të grantit.

6.2 Shpenzime që nuk mbulohen nga skema

Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga paratë e grantit përfshijnë:

- shpenzimet e lindura/krijuara përpara nënshkrimit të kontratës së grantit;
- mirëmbajtje dhe riparime;
- vlera e qerasë së ambjentit;
- blerjen e pasurive të patundshme (tokë, godina, etj.);
- blerjen e mjeteve të transportit;
- çdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar;
- zbavitje dhe dhurata.

7. Mbulimi gjeografik

Skema e dhënies së Granteve do të zbatohet në territorin e Bashkisë Shkodër.

8. Strukturat e menaxhimit të skemës

8.1 Komisioni për Vlerësimin

Komisioni i Vlerësimit të aplikimeve është organi i krijuar nga bashkia që bën vlerësimin e aplikimeve të dorëzuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në skemën e grantit. Puna e Komisionit të Vlerësimit do të jetë në përputhje me rregullat e skemës së grantit dhe kriteret e përcaktuara qartë për vlerësimin e aplikimeve.

9. Trajnuesit

Trajnuesit në planifikimin e biznesit do të ofrojnë trajnim për aplikantët e përzgjedhur. Qëllimi i tyre do të jetë të mësojnë të sipërmarrësit aspirantë se si mundet të ndërtohet një Plan Biznesi i qëndrueshëm.

10. Mënyra e procedimit të skemës së grantit

“Skema e grantit” do të zbatohet në dy faza kryesore. Secila fazë përfshin disa hapa, të cilat sigurojnë menaxhim efikas dhe transparencë, si më poshtë:

Faza I:

- Shpallja e thirrjes dhe zhvillimi i një fushate informuese;
- Përzgjedhja e ideve të aplikantëve;

Faza II:

- Pergatitja dhe aplikimi i planeve të biznesit;
- Vlerësimi dhe përzgjedhja e planeve më të mira të biznesit;
- Kontraktimi dhe përdorimi i fondeve;
- Monitorimi dhe vlerësimi.

10.1 Shpallja e thirrjes dhe zhvillimi i një fushate informuese;

Thirrjet për shprehjen e interesit do të shpallen në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër. I gjithë procesi do të kalojë në dy faza:

- Faza I: Organizimi i thirrjes dhe dorëzimi i ideve të biznesit;
- Faza II: Dorëzimi i planeve të biznesit për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.

Faza I: Organizimi i thirrjes dhe dorëzimi i ideve të biznesit;

Një fushatë informuese do të organizohet gjatë kohëzgjatjes së thirrjes, me qëllim njohjen e aplikuesve të mundshëm me kriteret e kësaj skeme, mënyrën e aplikimit, etj.

Shpallja e skemës së grantit do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe Faza e I-rë do të qendrojë e hapur deri **me datë 22/05/2026, ora 16:00**. Ajo do të përmbajë:

- Formularin e Aplikimit për ide biznesi për grantin;

Si dhe të tjera dokumenta mbështetës si më poshtë vijon:

1. Kopja e kartës së identitetit të Aplikantit;
2. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT), për bizneset ekzistuese;
3. Vertetim xhiro për 3 vitet e kaluara nga e-albania për bizneset ekzistuese;
4. Vërtetim për saktësim adrese.

10.2 Dorëzimi i aplikimit për ide biznesi (Aneksi 3)

Aplikimet për ide biznesi të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm duhet të dorëzohen pranë sportelit të ZIN, në Bashki në tre (3) kopje të printuara dhe një kopje elektronike (në CD ose USB) dorazi, në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar emri i thirrjes publike ***Formular aplikimi për pjesëmarrjen në skemën e granteve për biznese inovative***, emri i plotë dhe adresa e aplikantit.

Afati i dorëzimit të aplikimeve është **22/05/2026**, gjatë ditëve të punës (e hënë deri në të premte), midis orës 08:00 dhe 16:00, në adresën:

Zyra me Një Ndalesë (Z1N), Bashkia Shkodër
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1
4001, Shkodër

Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresë tjera nuk do të merren parasysh.

Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm.

Aplikimet pranohen sipas procedurave të mëposhtme:

- Një verifikim formal i adresës, kryhet në sportelin e Z1N, dokumentet të cila nuk kanë adresë, nuk do të pranohen;
- Çdo kandidati i caktohet një numër reference me datën dhe orën e dorëzimit.

10.3 Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve

Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve do të kalojë në dy faza të cilat janë:

- Faza e 1: Vlerësimi i aplikimit të ideve të biznesit;
- Faza e 2: Vlerësimi i planit të biznesit (*për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.*)

Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikimit të ide bizneseve dhe planit të biznesit do të kryhet nga Komisioni i Vlerësimit. Procesi për vlerësim administrativ dhe përzgjedhja e kandidatëve do të përfundojë jo më vonë se 5 ditë punë pas afatit përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve të ide bizneseve.

Secili anëtar i Komisionit do të vlerësojë secilën ide biznes (Faza I) dhe plan biznesi (Faza II-) individualisht si më poshtë:

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(1) Kushteve administrative:

- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të thirrjes.
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).

(1) Kushtet që kanë të bëjnë me Aplikuesin dhe aktivitetet:

- Konfirmimi se aplikuesi, dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuar në Udhëzuesin për Aplikime

(3) Vlerësimi i cilësisë së aplikimit të idesë së biznesit dhe vlerësimi i planit të biznesit dhe të dhënave financiare:

Vlerësimi i aplikimeve do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuar në Tabelat Vlerësuese të Fazës së I-rë dhe të II-të, që janë pjesë përbërëse e këtij dokumenti. Ka dy lloje të kriterëve vlerësuese: kriteret e idesë së biznesit, kriteret e planit të biznesit.

Ju lutemi kushtoni vëmendje informacionit në vijim:

Për te dyja fazat kriteret e pikëzimit ndahen në seksione dhe nën-seksione. *Çdo nën-seksion duhet vlerësuar me pikët e përcaktuara nga 1 në 5 sipas mënyrës së mëposhtme: 1 = shumë i keq; 2 = i keq; 3 = i përshtatshëm; 4 = i mirë; 5 = shumë i mirë.* Çdo anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësimi dhe të gjithë anëtarët nënshkruajnë tabelën përmbledhëse të vlerësimit të aplikimeve. Renditja e aplikimeve bëhet duke u nisur nga aplikimi me numrin më të madh të pikëve, i ndjekur nga aplikimi pasardhës me më pak pikë.

Shënim për Fazën e 1. Vlerësimi i zhvillimit të idesë së biznesit

Vlerësimi maksimal për fazën e vlerësimit të zhvillimit të idesë së biznesit është 35 pikë. Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Fazën e I-rë është më i ulët se 20 pikë, sepse aplikimi i dorëzuar nuk garanton cilësinë e aplikimit.

Shënim për Fazën e II-të. Kriteret e Planit të Biznesit dhe Financimit

Vlerësimi maksimal për fazën e vlerësimit të planit të biznesit është 65 pikë.

Projekti përjashtohet nga shqyrtimi i mëtejshëm në rast se numri total i pikëve në Fazën 2 është më i ulët se 45 pikë, sepse pikët tregojnë se megjithëse aplikanti garanton cilësinë e aplikimit, aplikimi nuk ofron një analizë të mirëfilltë financiare dhe plani i biznesit nuk është relevant.

Nëse gjatë procesit të vlerësimit konstatohet se dokumentet e aplikantit janë të rreme, këta aplikantë do të përjashtohen menjëherë. Komisioni do të paraqesë arsye për refuzimin e ideve të biznesit për cdo aplikim.

Për të dyja fazat e vlerësimit, Komisioni rendit vlerësimin e aplikimeve sipas pikëve përfundimtare. *Të gjithë aplikimet të cilët kanë marrë vlerësime prej 65 pikësh ose më shumë do të pranohen për tu financuar, sipas fondeve në dispozicion.*

Hapi i parë: Vlerësimi administrativ

Komisioni kontrollon nëse aplikimet janë dorëzuar brenda kohëzgjatjes së thirrjes. Në rast se aplikimi nuk i plotëson kriteret teknike apo është dorëzuar përtej afateve të thirrjes, ai përjashtohet nga vlerësimi i mëtejshëm dhe shpallet i skualifikuar.

Hapi i dytë: Vlerësimi teknik dhe përzgjedhja e fituesve të Ideve të Biznesit.

Pas vlerësimit administrativ do të shqyrtohet përmbajtja e aplikimit të Idesë së Biznesit sipas kriterëve të përcaktuara.

10.4 Shpallja e rezultateve

Me përfundimin e procesit, rezultatet përfundimtare të vlerësimit nxirren në faqen e internetit

të bashkisë. Për këtë qëllim, bashkia përgatit një pasqyrë në formë tabele të të gjithë aplikantëve dhe pikëve totale të marra nga secili. Secili aplikant do të marrë një *Njoftim* me shkrim për rezultatet.

10.5 Pjesëmarrja në trajnim, zhvillim, dhe paraqitja e planëve të biznesit

Përshkrimi i trajnimit

Të gjithë të interesuarit do të kenë mundësinë të marrin pjesë në një kurs trajnimi për planifikimin e biznesit të organizuar nga Bashkia, i cili do të zgjasë nga data 4 - 12 qershor 2026. Aplikantët e shpallur fitues do të trajnohen edhe gjatë zbatimit të aplikimit. Trajnuesit dhe mjediset për trajnim do të vihen në dispozicion nga Bashkia. Gjithashtu gjatë zbatimit të projektit, aplikantët mund të konsultohen me trajnuesit për planet e tyre të biznesit. Trajnimi do të përqendrohet në mënyrën se si të hartohet një plan biznesi për Thirrjen.

Të gjitha datat e takimeve informuese, njoftimet dhe materialet e tjera do të publikohen në faqen e Bashkisë Shkodër.

Faza II: Plani i biznesit (*për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.*)

Formati i Planit të Biznesit

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të fillojnë të punojnë në planet e tyre të biznesit, duke përdorur *Formatin e Planit të Biznesit* dhe *dokumentet përkatëse* që do t'u dorëzohen secilit kandidat që arrin këtë fazë. Planet e biznesit duhet të zhvillohen dhe dorëzohen deri më **datë 26.06.2026, ora 16:00**. Gjatë kësaj periudhe, aplikantët mund të kërkojnë konsulencë nga trajnuesit për planet e tyre të biznesit.

Faza e 2: Dorëzimi i planit të biznesit për të gjithë aplikimet e kualifikuara në fazën e parë.

1. Plani i Biznesit dhe Financimit sipas modelit të kërkuar;

Dokumenta shoqërues shtesë për fazën e II-të:

- ✓ Dorëzimi i pasqyrave financiare (bilanci) për dy vitet e fundit të aktivitetit të biznesit;
- ✓ Çertifikime/patenta, apo dokumente të tjerë suportues të cilët vërtetojnë elementin inovativ përbëjnë prioritet; (Nëse kanë);
- ✓ Vërtetim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëse aplikanti nuk ka detyrime financiare ndaj këtij institucioni (për aplikantët të cilët kanë biznes ekzistues);
- ✓ Dëshmi penaliteti e aplikuesit, lëshuar gjatë muajit të hapjes së thirrjes;

Dorëzimi i Planeve të Biznesit

Planët e biznesit duhet të dorëzohen të plotësuar me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm duhet të dorëzohen pranë sportelit të ZIN, në Bashki në tre (3) kopje të printuara dhe një kopje elektronike (në CD ose USB) dorazi, në një zarf të vulosur mbi të

cilin është shkruar emri i thirrjes publike *Formular aplikimi për pjesëmarrjen në skemën e granteve për biznese inovative*, emri i plotë dhe adresa e aplikantit.

Afati i dorëzimit të aplikimeve është **data 26.06.2026**, gjatë ditëve të punës (e hënë deri në të premte), midis orës 08:00 dhe 16:00, në adresën: adresa e bashkisë:

Zyra me Një Ndalesë (Z1N), Bashkia Shkodër
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1
4001, Shkodër

Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (me postë, faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa tjera nuk do të merren parasysh.

Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm.

Aplikimet pranohen sipas procedurave të mëposhtme:

- Një verifikim formal i adresës, kryhet në sportelin e Z1N, dokumentet të cila nuk kanë adresë, nuk do të pranohen;
- Çdo kandidati i caktohet një numër reference me datën dhe orën e dorëzimit.

10.6 Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve të Planeve të Biznesit

Shqyrtimi dhe vlerësimi i Aplikimit të Planit të Biznesit do të kryhet nga Komisioni i Vlerësimit.

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(1) Kushteve administrative:

- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të thirrjes.
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).

(2) Kushtet që kanë të bëjnë me Aplikuesin dhe aktivitetet:

- Konfirmimi se aplikuesi, dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuar në Udhëzuesin për Aplikime

(3) Vlerësimi i cilësisë së aplikimit të Planit të biznesit

Vlerësimi i aplikimeve do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuar në Formularin e Vlerësimit që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Kur dokumentet e aplikimit nuk janë plotësuar ose nuk përputhen me kërkesat e thirrjes, aplikantët do të përjashtohen nga konkurimi. Vetëm planet e biznesit që përmbajnë dokumentim të plotë dhe që janë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë do të pranohen për vlerësim. Ky proces do të përfundojë jo më vonë se 5 ditë punë pas afatit përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve të Planit të Biznesit.

Kriteret për realizueshmërinë e planit të biznesit

Vlerësimi maksimal është 65 pikë, dhe matet nga elementët e mëposhtëm:

- Realizueshmëria financiare e biznesit;

- Burimet e disponueshme për biznesin – mjediset, pajisjet, furnizimet dhe personeli;
- Menaxhimi i rrishtit;
- Njohuritë lidhur me llojin përkatës të biznesit;
- Vlerësimi i tregut.

***Shënim:** Vlerësimi total është 100 pikë, prej të cilave 35 pikë vijnë nga Faza I-rë dhe 65 pikë nga Faza II-të.*

Komisioni i Vlerësimit, pas shqyrtimit të vlerësimit, ka të drejtën të kërkojë që aplikantët që kanë kaluar në fazën e dytë të vlerësimit të paraqesin planet e tyre të biznesit përmes një prezantimi. Pas këtij prezantimi, komisioni do të vijojë me vlerësimin përfundimtar, renditjen e fituesve dhe propozimin për financim.

10.7 Ankesat.

Pas botimit zyrtar të rezultateve, për secilën Fazë, aplikuesit kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin brenda 5 ditësh punë nga marrja e njoftimit.

Nëse gjatë procesit të vlerësimit konstatohet se dokumentet e aplikantit janë të rreme, këta aplikantë do të përjashtohen menjëherë.

Pikët përfundimtare për secilën ide biznesi janë mesatarja e pikëve të anëtarëve të Komisionit.

Së fundi, Komisioni rendit aplikantët sipas pikëve përfundimtare të secilës ide biznesi në rendin zbritës (nga aplikanti me pikët më të larta te ai me pikët më të ulëta). (Aplikantët me 65 pikë e lart do të përzgjidhen).

10.8 Rishikimi i projektit pas miratimit të grantit.

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, aplikanti që ka pasur sukses në aplikim do të ofrohet një kontratë për zbatimin e projektit. Para se të nënshkruajë kontratën dhe nëse është e nevojshme, Bashkia Shkodër ka të drejtën ti kërkojë subjektit aplikues modifikime të caktuara në projekt (buxhet dhe planin e biznesit) për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit, pa cenuar thelbin e projekt propozimit.

11. Kontraktimi dhe Përdorimi i Fondeve

11.1 Kontrata e Grantit

Për aplikantët e shpallur fitues në të dyja fazat, përpara lidhjes së kontratave duhet të dorëzojnë:

- **Bizneset e reja** duhet të kryejnë regjistrimin e tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe të dorëzojnë certifikatën përkatëse para nënshkrimit të kontratës. Pas regjistrimit, bizneset e reja duhet të dorëzojnë vertetimin origjinal të llogarisë bankare në lek, së bashku me certifikatën e regjistrimit në QKB.
- **Bizneset ekzistuese** duhet të dorëzojnë vertetimin origjinal të llogarisë bankare në lekë, së bashku me certifikatën e regjistrimit në QKB.
- Çdo dokument që **verteton pronësinë ose të drejtën e përdorimit të ambienteve**, si

- dhe **licencat, lejet apo autorizimet e nevojshme** për ushtrimin e aktivitetit.
- **Deklarata De Minimis**

Procesi për regjistrimin e enteve ligjore (vetëm për individët) dhe firmosja e kontratës së grantit do të koordinohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrushëm Ekonomik, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit. Pas regjistrimit, të gjithë aplikantët e miratuar duhet të hapin një llogari bankare në emër të biznesit të tyre. (llogari biznesi).

Bashkia e Shkodrës do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës, sipas realizimit të buxhetit të përcaktuar në aplikim, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate. Kohëzgjatja e projekteve duhet të jetë nga lidhje e kontratës deri me 31 dhjetor 2026.

12. Monitorimi dhe Vlerësimi

Bashkia Shkodër do të ndjekë ecurinë e zbatimit të projekteve fituese, nëpërmjet grupit të monitorimit pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër.